



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 73, DATË 03.09.2020

MBI
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “MEDIA MOTIV” SH.A., PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT AUDIO PRIVAT “RADIO MOTIV”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Media Motiv” sh.a.,

Objekt: Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “Radio Motiv”

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, germa “a” i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, rregullorja “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar

VËREN

Shoqëria “Media Motiv” sh.a., është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 32, datë 26.03.2012, për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Motiv”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge për të mbuluar me sinjal Rrethin Shkodër. Afati i vlefshmërisë së licencës së këtij subjekti ka përfunduar në datën 11.05.2015.

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrave nr. 120, datë 15.11.2017 dhe nr. 140, datë 07.12.2017, të Kryetarit të AMA-s, u

mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimet nr. 3253 prot., datë 13.11.2017 dhe nr. 3703 prot., datë 24.11.2017 të shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “Radio Motiv”.

Aplikimi i subjektit ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, pasi nuk ishin paraqitur:

- Garancia bankare në masën 10% të kapitalit e bllokuar, për një periudhë 6 mujore jo më pak se 250,000 lekë;
- Karakteristikat teknike të transmetimit (frekuenca, fuqia efektive e rrezatuar, përforcimi i antenës), bllokskema e detajuar për pikën transmetuese Tarabosh, bllokskema e studios së transmetimit, të dhënat e sistemit të antenave dhe karakteristikat teknike të tyre (diagramat H dhe V), lista e pajisjeve të transmetimit dhe karakteristikat teknike të tyre, identifikimi i prezencës RDS;
- Lista emërore e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe Curriculum Vitae të tyre (të cilat duhet të jenë të firmosura).

Duke qenë se aplikimi rezultoi me mangësi, AMA, gjatë periudhës 2018-2020, me shkresat nr. 185 prot., datë 11.01.2018, nr. 1579 prot., datë 05.04.2018, nr. 2528 prot., datë 05.06.2018, nr. 3632 prot., datë 06.09.2018, nr. 4981 prot., datë 26.12.2018, nr. 4092 prot., datë 12.11.2019, nr. 4470 prot., datë 19.12.2019, nr. 55 prot., datë 08.01.2020, nr. 1926 prot., datë 09.07.2020 dhe nr. 1926/1 prot., datë 13.08.2020, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur, plotësimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës.

AMA, vëren se në cilësinë e organit kolegjal ka marrë disa herë në shqyrtim çështjen e rinovimit të licencës së këtij subjekti duke i dhënë mundësi për depozitim të dokumentacionit plotësues, ndërkohë që nga subjekti nuk ka patur reagim.

Në shkresën e fundit, të dërguar në muajin gusht, subjektit i është bërë me dije se nëse nuk do të depozitohet dokumentacioni i kërkuar brenda datës 31 gusht 2020, AMA do të vendosë rrëzimin e aplikimit për rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio Motiv” dhe mosrinovimin e licencës së subjektit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 në masën 159,000 lekë, prej të cilave 150,000 lekë për pagesë vjetore për licencë dhe 9,600 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive, të njoftuara me shkresën nr. 335 prot., datë 28.01.2020.

Gjithashtu, subjekti është rikujtuar për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 me shkresat me nr. 1463 prot., datë 10.06.2020 dhe nr. 1591 prot., datë 19.06.2020.

AMA, konstaton se subjekti, pavarësisht njoftimeve dhe kërkesave të përsëritura për të depozituar aplikimin në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nuk ka depozituar dokumentacion shtesë.

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se: *“Licenca... bëhet e pavlefshme kur... mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar”*.

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin që aplikimi i shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio “Radio Motiv”, duhet të rrëzohet,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 68, germa “a” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mosrinovimin e licencës së shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për subjektin audio privat vendor “Radio Motiv”.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Media Motiv” sh.a., për subjektin audio privat vendor “Radio Motiv”.
3. Shoqëria “Media Motiv” sh.a., me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA